URDHËR
Nr. 266, datë 21.4.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË BIZNESEVE, SIPAS NIVELEVE TË RISKUT DHE MIRATIMIN E PROTOKOLLEVE TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 4, të nenit 7 dhe të nenit 21, pika 3, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe të sëmundjeve infektive", të ndryshuar, në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, si edhe në zbatim të vendimit nr. 1892, datë 20.4.2020, të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Miratimin e udhëzimit të përgjithshëm për masat që duhet të ndërmarrin bizneset (sipas niveleve të riskut) për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 gjatë ushtrimit të aktivitetit.
2. Kategorizimin e bizneseve, sipas niveleve të riskut të përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, në kategori me risk të ulët (kodi jeshil), me risk të mesëm (kodi i verdhë) dhe me risk të lartë (kodi i kuq), sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij urdhri.
3. Miratimin e protokolleve të posaçme për plotësimin e masave higjieno-sanitare, distancimit social dhe masave specifike, për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, për secilën nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri.
4. Instituti i Shëndetit Publik për kategori specifike biznesi sipas niveleve të riskut, harton protokolle të detajuara, për masa specifike, që duhet të ndërmerren nga biznesi për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM
PËR REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME NDAJ SUBJEKTEVE TË BIZNESIT QË LEJOHEN TË ZHVILLOJNË AKTIVITETIN NË KUSHTET E LEHTËSIMIT TË MASAVE TË MARRA PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të orientojë dhe t'u rekomandojë punëdhënësve praktikat e duhura të kufizimit të përhapjes së COVID-19, duke sjellë zvogëlimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve për të ruajtur vijimësinë e biznesit dhe krijimin e një ambienti pune të shëndetshëm.

Çdo subjekt duhet të respektojë masat e rekomanduara nga ISHP-ja nëpërmjet një plani individual veprimi, duke respektuar çdo element për kufizimin e transmetimit të COVID-19 te punonjësit, brenda ambienteve të biznesit.

Zbatimi i këtij udhëzimi siguron:
1. Reduktimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve;
2. Sigurimin e një ambienti të shëndetshëm në punë;

3. Vijimësinë normale të aktivitetit të biznesit.

- Punëdhënësi është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshëm të elementeve të higjienës, ku përfshihen: sapun i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim, letra dhe dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve dhe sigurimi i koshave të mbyllur për eliminimin e mbetjeve.
- Punëdhënësi është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshëm të mjeteve të mbrojtjes personale, si: maska dhe doreza (maskat mund të jenë dhe prej cope dhe të ndërrohen çdo ditë). Punëdhesit duhet të sigurojnë përdorimin e maskave dhe të dorezave, si barrierë fizike për minimizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19.
- Punëdhënësi duhet të vendosë postera që inkurajojnë higjienën e duarve për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes në hyrje të vendit të punës dhe në zona të tjera të vendit të punës ku janë të dukshme.
- Punëdhënësi të rekomandojë që të mos përdoret shtrëngimi i duarve dhe përqafimet midis punonjësve dhe të inkurajojë përdorimin e metodave të tjera jokontaktuese të përshëndetjes.
- Punëdhënësit duhet të hartojnë politika të brendshme të subjektit, siç janë mundësim të punës nga shtëpia ose orë fleksibël, të cilat lejojnë të rritet distanca fizike nga një punonjës në tjetrin ose/dhe krijojnë mundësinë e këtyre punonjësve të jenë në distancë 2 metra nga njëri-tjetri.
- Punonjësve t'u kërkohet të aplikojnë larjen e duarve ose përdorimin e dezinfektantëve, kur ato janë të ndotura ose pas heqjes së maskës dhe dorezave (mbështetur në udhëzuesin e MSHMS-së mbi hapat dhe mënyrën e larjes së duarve).
- Punëdhënësit nuk duhet të lejojnë punonjësit e tyre të përdorin mjetet e njëri-tjetrit dhe postet e ndërsjella të punës.
- Punëdhënësit duhet të nxisin punonjësit e tyre për respektimin e praktikave të etikës respiratore, kollitjes e teshtitjes, duke përdorur vënien e gropëzës së bërrylit përpara gojës dhe të hundës.
- Punonjësit duhet të respektojnë masat e distancimit social, të cilat do të kryhen sipas një plani të vetë bizneseve dhe të theksohet nëse kapaciteti i punëtorëve kalon për sipërfaqe në m^2, duke respektuar distancën 2 m, bizneset të punojnë në dy turne sipas orarit të lejuar.
- Punëdhënësit duhet të inkurajojnë:
- zbatimin e vendeve të punës fleksibël (p.sh., punë në distancë);
- zbatimin e orëve fleksibël të punës (p.sh., ndërrime të orarit të punës);
- rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve në vendin e punës;
- rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve dhe klientëve (p.sh., përmes ndarjeve);
- zbatimin e opsioneve fleksibël të takimit dhe të e udhëtimit (p.sh., shtyrja e takimeve ose ngjarjeve jothelbësore);
- uljen e disa shërbimeve apo të produkteve;
- ofrimin e shërbimeve nga distanca (p.sh. telefon, video ose *web*);
- dorëzimin e produkteve përmes marrjes në dorëzim, sipas një plani dhe duke siguruar distancat përkatëse.
- Bizneset duhet të praktikojnë pastrimin e vazhdueshëm të sipërfaqeve dhe elementeve të tjera të vendit të punës, si p.sh., si: stacionet e punës, tastierat, telefonat, parmakët dhe dorezat. Është e nevojshme që produktet dezinfektantë të kenë përqindjen, metodën e aplikimit dhe kohën e kontaktit të saktë, si dhe përdorimi i tyre duhet bërë duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale. (Mbështetur në udhëzuesin e MSHMS-së për pastrimin e mjedisit në objektet (jo të kujdesit shëndetësor) të ekspozuar ndaj COVID-19).
- Nëse sipërfaqet janë të ndotura, ato duhet të pastrohen duke përdorur një pastrues ose sapun dhe ujë para dezinfektimit.
- Për dezinfektim mund të përdoren dezinfektuesit shtëpiakë më të zakonshëm, si dhe të tjerë, sipas udhëzimeve të MSHMS-së. Ndiqni udhëzimet e prodhuesit për të gjitha produktet e pastrimit dhe dezinfektimit (p.sh., përqendrimi, metoda e aplikimit dhe koha e kontaktit etj.).

- Punëdhënësit duhet të këshillojnë punëtorët që të mos përdorin telefonat, tavolinat, zyrat ose mjetet dhe pajisjet e punëtorëve të tjerë, kur është e mundur. Nëse është e nevojshme, të pastrohen dhe të dezinfektohen ato para dhe pas përdorimit. Gjithashtu, duhet të sigurohen pastruesit e mundshëm, në mënyrë që sipërfaqet e përdorura zakonisht (për shembull, telekomandat, tastierat mjetet dhe pajisjet e tjera të punës etj.) mund të fshihen nga punonjësit para çdo përdorimi.

- Nëse në një subjekt, një nga punonjësit është apo ka pasur kontakt të ngushtë me një person pozitiv COVID-19, duhet të qëndrojë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë mjekun e biznesit dhe administratorin, i cili më pas njofton NJVKSH-në përkatëse.

- Punonjësit që kanë shenja klinike të qëndrojnë në shtëpi, të vetizolohen dhe të monitorojnë shenjat klinike dhe për çdo shqetësim të njoftojnë 127-ën dhe mjekun e familjes, si dhe të njoftojnë mjekun e biznesit dhe administratorin.

- Administratori i subjektit duhet të largojë punonjësin nga puna për të qëndruar në shtëpi, nëse ai shfaq shenja klinike dhe duhet të njoftojë menjëherë brenda 24 orëve NJVKSH-në dhe ISHP-në.

- Nëse ka një rast të dyshuar me COVID 19 nga mjeku i biznesit apo i ndërmarrjes duhet të njoftohet menjëherë NJVKSH-ja dhe ISHP-ja.

- Të minimizohet kontakti midis klientëve dhe punonjësve duke i zëvendësuar takimet fizike me komunikime *online*.

- Administratorët e bizneseve duhet të vendosin elementet e distancimit fizik me shenja vizuale të dukshme në sipërfaqen e dyshemesë, si dhe rregullorja mbi tërësinë e masave të minimizimit të transmetimit të COVID-19 të jetë e afishuar në mënyrë sa më të dukshme.

- Çdo biznes duhet të ketë një mjedis të caktuar për të izoluar një punonjës, i cili mund të shfaqë shenja klinike të sëmundjes dhe më pas lajmërohet 127-ta dhe NJVKSH-ja përkatëse.

- Çdo biznes që ka më shumë se 5 persona rekomandohet të vendosë kamera të survejancës për të vëzhguar nëse masat e përcaktuara të higjienës dhe të kujdesit zbatohen me saktësi.

- Distancimi social do të kryhet sipas një plani të vetë bizneseve për fasoneri, rrobaqepësi, *call center* etj., dhe nëse kapaciteti i punëtorëve kalon, normën e lejuar për sipërfaqe në m^2, duke respektuar distancën 2 m, bizneset të punojnë në dy turne, sipas orarit të lejuar, duke pasur të gjitha kushtet për të kryer dezinfektimin dhe duke përdorur maskat dhe dorezat në mënyrë të detyrueshme.

- Të konsiderohen përmirësimi i kontrolleve inxhinierike, duke përdorur sistemin e ventilimit të ndërtesave. Kjo mund të përfshijë disa ose të gjitha aktivitetet e mëposhtme:

- rritja e niveleve të ventilimit;

- rritja përqindjes se ajrit në natyrë që qarkullon në sistem.

Mbështetur në nivelet riskut nga niveli jeshil deri në nivelin e kuq për transmetimin e infeksionit COVID-19, të gjitha subjektet që janë në nivelin jeshil duhet përdorin dorezat, maskat mbrojtëse. Respektimi i distancës 2 m, vendosja e shenjave të pritjes në radhë, afishimi i mundësisë së blerjeve *online*, rezervimi takimi *online* apo me telefon, vendosja e xhamit mbrojtës klient shitës, dezinfektim i ambientit, larje para hapjes dhe pas mbylljes sidomos i tavolinave, banakëve, telefonave dhe çdo hapësire ku ka pasur kontakt me duar, ajrimi sipas mundësisë minimalisht 3 herë në ditë.

- Në nivelin portokalli dhe të kuq do të kërkohet frekuencë e shtuar e ajrimit, dezinfektim me tunel *spray* në hyrje dhe në dalje të biznesit për të gjithë punonjësit. (Mbështetur në udhëzuesin e MSHMS-së për pastrimin e mjedisit në objektet (jo të kujdesit shëndetësor) të ekspozuar ndaj Covid-19.)

- ISHSH-ja duhet të kryejë inspektimin sistematik për vlerësimin e zbatimit të masave përkundrejt penaliteteve në fuqi.

- Bizneset duhet të jenë të përgatitura që vlerësimi në mënyrë sistematike i situatës epidemiologjike (rritje e rasteve pozitive, shtim i rasteve të hospitalizuara etj.) do të sjellë për pasojë rishtrëngim të masave të lejuara.

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	111	Kultivimi i drithërave (përveç orizit), të bimëve bishtajore dhe farërave vajore	
Lejohen	112	Kultivimi i orizit	
Lejohen	113	Kultivimi i perimeve dhe pjepër e shalqi, rrënjore dhe tuberozë	
Lejohen	114	Kultivimi i kallamsheqerit	
Lejohen	115	Kultivimi i duhanit	
Lejohen	116	Kultivimi i bimëve fibroze	
Lejohen	119	Kultivimi i bimëve të tjera joshumëvjeçare	
Lejohen	121	Kultivimi i hardhive	
Lejohen	122	Kultivimi i frutave tropikale dhe subtropikale	
Lejohen	123	Kultivimi i agrumeve	
Lejohen	124	Kultivimi i frutave me bërthame dhe frutave me farë	
Lejohen	125	Rritja e të tjera pemëve e shkurreve frutore dhe e frutave të thata	
Lejohen	126	Rritja e frutave vajore	
Lejohen	127	Kultivimi i kulturave për pije	
Lejohen	128	Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore	
Lejohen	129	Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare	
Lejohen	130	Shumimi i bimëve	
Lejohen	141	Rritja e gjedhëve për qumësht	
Lejohen	142	Rritja e të tjera gjedhëve dhe buall	
Lejohen	143	Rritja e kuajve dhe njëthundrakëve	
Lejohen	145	Rritja e dhenve dhe e dhive	
Lejohen	146	Rritja e derrave	
Lejohen	147	Rritja e shpendëve	
Lejohen	149	Rritja e kafshëve të tjera	
Lejohen	150	Ferma mikse	
Lejohen	161	Aktivitete ndihmëse për prodhimin bimor	
Lejohen	162	Aktivitete ndihmëse për prodhimet blegtorale	
Lejohen	163	Punime të paskorrjes së bimëve	
Lejohen	164	Përpunimi i farërave për shumim	
Lejohen	170	Gjuetia, zënia me gracka dhe shërbime të lidhura me këto	
Lejohen	210	Silvikultura dhe aktivitete të tjera pyjore	
Lejohen	220	Shfrytëzimi i pyjeve	
Lejohen	230	Mbledhja e produkteve pyjore të egra jodrusore rritur në natyrë	
Lejohen	240	Shërbime mbështetëse ndaj pyjeve	
Lejohen	311	Peshkimi detar	
Lejohen	312	Peshkimi në ujëra të ëmbla	
Lejohen	321	Akuakultura detare	
Lejohen	322	Akuakultura në ujra të ëmbla	
Lejohen	610	Nxjerrja e naftës bruto	
Lejohen	620	Nxjerrja e gazit natyror	
Lejohen	811	Nxjerrja nga karriera e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gipsit, shkumës dhe rrasave	
Lejohen	812	Operacionet e nxjerrjes së zhavorrit dhe të rërës, nxjerrja e argjilës dhe kaolinës;	
Lejohen	891	Nxjerrja e mineraleve kimike dhe plehrave kimike	
Lejohen	892	Nxjerrja e torfave	
Lejohen	893	Nxjerrja e kripës	
Lejohen	899	Industri të tjera nxjerrëse p.k.t.	
Lejohen	910	Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe të gazit natyror	
Lejohen	990	Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka dhe karrierat	
Lejohen	1102	Prodhimi i verës nga rrushi	0–25 punëtorë: protokoll jeshil; 25–50 punëtorë: protokoll portokalli; mbi 50 punëtorë protokolli i kuq
Lejohen	1103	Prodhimi i mushtit dhe i verërave të tjera me bazë frutash	
Lejohen	1394	Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave	
Lejohen	1610	Sharrimi dhe zdrukthimi i drurit	
Lejohen	1621	Prodhimi i kompensatës, rimesos dhe paneleve të veçanta	
Lejohen	1622	Prodhimi i parketeve për dysheme të montuar	
Lejohen	1623	Prodhimi i karpentierëve të ndërtuesve dhe zdrukthëtarive	
Lejohen	1624	Prodhimi i kontejnerëve prej druri	
Lejohen	1629	Prodhimi i produkteve të tjera prej druri; prodhimin e artikujve prej xunkthi, shporte dhe	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	1711	Prodhimi i brumit të letrës	
Lejohen	1712	Prodhimi i letrës dhe kartonit	
Lejohen	1721	Prodhimi i letrës dhe kartonit të zhubrosur dhe të ambalazhit të letrës dhe të kartonit	
Lejohen	1722	Prodhimi i artikujve prej letre me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit	
Lejohen	1723	Prodhimi i letrës së zakonshme të palëvizshme	
Lejohen	1724	Prodhimi i letrës së murit	
Lejohen	1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letre dhe kartoni të p.k.t.	
Lejohen	1811	Shtypshkrimi i gazetave	
Lejohen	1812	Të tjera shtypshkrime	
Lejohen	1813	Shërbime të parashtypshkrimit dhe parakomunikimit	
Lejohen	1814	Lidhja dhe shërbime të lidhura me të	
Lejohen	1820	Riprodhimi i regjistrimeve të mjeteve të komunikimit	
Lejohen	1910	Përpunimi i produkteve të furrës së koksit	
Lejohen	1920	Përpunimi i produkteve të rafinerisë së naftës	
Lejohen	2011	Prodhimi i gazit industrial	
Lejohen	2012	Prodhimi i ngjyruesve dhe i pigmenteve	
Lejohen	2013	Prodhimi i kimikateve të tjera me bazë inorganike	
Lejohen	2014	Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike	
Lejohen	2015	Prodhimi i plehrave kimike dhe i komponimeve të azotit	
Lejohen	2016	Përpunimi i materialeve plastike në formë primare	
Lejohen	2017	Përpunimi i kauçukut sintetik në formë primare	
Lejohen	2020	Përpunimi i pesticideve dhe i produkteve të tjera agrokimike	
Lejohen	2030	Përpunimi i bojërave, vernikëve dhe shtresave të ngjashme, bojë shkrimi dhe mastiç	
Lejohen	2041	Përpunimi i sapunëve dhe detergjenteve, solucioneve të pastrimit dhe shkëlqimit	
Lejohen	2051	Përpunimi i eksplozivëve	
Lejohen	2052	Përpunimi i ngjitësve	
Lejohen	2053	Përpunimi i vajrave esenciale	
Lejohen	2059	Përpunimi i produkteve të tjera kimike p.k.t.	
Lejohen	2060	Përpunimi i fibrave sintetike dhe artificiale	
Lejohen	2110	Përpunimi i produkteve farmaceutike bazë	
Lejohen	2120	Përpunimi i preparateve farmaceutike	
Lejohen	2211	Prodhimi i gomave dhe i kamerdareve, riveshja dhe rikonstruktimi i gomave dhe kamerdareve	
Lejohen	2219	Prodhimi i produkteve të tjera prej kauçuku	
Lejohen	2221	Prodhimi pllakave, fletëve, tubave dhe profileve prej plastike	
Lejohen	2222	Prodhimi i mallrave të paketimit prej plastike	
Lejohen	2223	Prodhimi i mallrave plastike për ndërtim	
Lejohen	2229	Prodhimi i produkteve të tjera plastike	
Lejohen	2311	Fabrikimi i qelqit të sheshtë	
Lejohen	2312	Dhënia e formës dhe transformimi i qelqit të sheshtë	
Lejohen	2313	Prodhimi i qelqit të lugët	
Lejohen	2314	Prodhimi i fibrave të qelqit	
Lejohen	2319	Prodhimi dhe transformimi i qelqeve të tjera, duke përfshirë qelqin teknik	
Lejohen	2320	Prodhimi i produkteve refraktare	
Lejohen	2331	Prodhimi i tullave dhe i tjegullave prej qeramike	
Lejohen	2332	Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produktet e ndërtimit, në argjilë të pjekur	
Lejohen	2341	Prodhimi i artikujve prej qeramike për përdorim shtëpiak dhe zbukurues	
Lejohen	2342	Prodhimi i pajisjeve sanitare prej qeramike	
Lejohen	2343	Prodhimi i izolatorëve qeramikë dhe pajisjeve izoluese	
Lejohen	2344	Prodhimi i produkteve të tjera qeramike teknike	
Lejohen	2349	Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramike	
Lejohen	2362	Prodhimi i produkteve prej allçie për qëllime ndërtimi	
Lejohen	2363	Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm për përdorim	
Lejohen	2364	Prodhimi i llaçit	
Lejohen	2365	Prodhimi i produkteve me fibra të çimentuara	
Lejohen	2369	Prodhimi i artikujve të tjerë prej betoni, allçie dhe çimentoje	
Lejohen	2370	Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni	
Lejohen	2391	Prodhimi i produkteve abrazive	
Lejohen	2431	Tërheqja në të ftohtë e shufrave	
Lejohen	2432	Petëzimi në të ftohtë i rripave	
Lejohen	2433	Profilizimi në të ftohtë me anë të përkuljes	
Lejohen	2434	Trafilimi në të ftohtë i telave	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	2441	Prodhimi i metaleve të çmuara	
Lejohen	2446	Përpunimi i metaleve nukleare	
Lejohen	2512	Prodhimi i dyerve dhe i dritareve metalike	
Lejohen	2521	Prodhimi i radiatorëve dhe i bolierëve për ngrohje qendrore	
Lejohen	2529	Prodhimi i çisternave të tjera, rezervuarëve dhe mbajtësve prej metali	
Lejohen	2530	Prodhimi i gjeneratorëve të avullit, përveç bolierëve me ujë të ngrohtë për ngrohje qendrore	
Lejohen	2540	Prodhimi i armëve dhe municioneve	
Lejohen	2550	Farkëtimi, kovaçana, stampimi dhe petëzimi, pluhuri metalurgjik	
Lejohen	2561	Trajtimi dhe veshja e metaleve	
Lejohen	2562	Instrumentet	
Lejohen	2571	Prodhimi i thikave	
Lejohen	2572	Prodhimi i kyçeve dhe i menteshave	
Lejohen	2573	Prodhimi i veglave	
Lejohen	2591	Prodhimi i kovave me çikrik prej çeliku dhe mbajtës të tjerë të ngjashëm	
Lejohen	2592	Prodhimi i ambalazheve prej metali të lehtë	
Lejohen	2593	Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe sustë	
Lejohen	2594	Prodhimi i dadove dhe i bulonave	
Lejohen	2599	Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t.	
Lejohen	2611	Prodhimi i bazamentëve elektronikë	
Lejohen	2612	Prodhimi i mbajtësve elektronikë të loduar	
Lejohen	2620	Prodhimi i kompjuterave dhe pjesëve periferike	
Lejohen	2630	Prodhimin e pajisjeve të komunikimit	
Lejohen	2640	Prodhimi i produkteve, elektronikave për konsumatorët	
Lejohen	2651	Prodhimi i instrumenteve dhe aparateve për matje, verifikim, kontrolle	
Lejohen	2652	Prodhimi i orëve dhe orëve të murit	
Lejohen	2660	Prodhimi i pajisjeve rrezatuese, elektromjekësore dhe elektroterapiste	
Lejohen	2670	Prodhimi i instrumenteve dhe i pajisjeve optike	
Lejohen	2680	Prodhimi i mjeteve të komunikimit optike dhe manjetike	
Lejohen	2711	Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe transformatorëve	
Lejohen	2712	Prodhimi i aparaturave të shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike	
Lejohen	2720	Prodhimi i baterive dhe i akumulatorëve	
Lejohen	2731	Prodhimi i kabllove të fibrave optike	
Lejohen	2732	Prodhimi i telave dhe i kabllove të tjera elektrike dhe elektronike	
Lejohen	2733	Prodhimi i telave transmetues	
Lejohen	2740	Prodhimi i pajisjeve elektrike të ndriçimit	
Lejohen	2751	Prodhimi i aparateve shtëpiakë elektrike	
Lejohen	2752	Prodhimi i pajisjeve shtëpiake joelektrike	
Lejohen	2790	Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike	
Lejohen	2811	Prodhimi i motorëve dhe i turbinave, përveç motorëve e avionëve, automjeteve dhe motoçikletave	
Lejohen	2812	Prodhimi i pajisjeve hidraulike	
Lejohen	2813	Prodhimi i pompave dhe kompresorëve të tjerë	
Lejohen	2814	Prodhimi i tapave dhe valvolave	
Lejohen	2815	Prodhimi i kushinetave, ingranazheve, grupeve të ingranazheve dhe elementet e drejtimit	
Lejohen	2821	Prodhimi i furrave, furrnaltave dhe aparaturave për djegie	
Lejohen	2822	Prodhimi i pajisjeve të ngritjes dhe të zhvendosjes	
Lejohen	2823	Prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve të zyrave, përveç kompjuterave dhe pajisjeve periferike	
Lejohen	2824	Prodhimi i veglave portative me motor të inkorporuar	
Lejohen	2825	Prodhimi i pajisjeve ftohëse dhe ventiluese joshtëpiake	
Lejohen	2829	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm të p.k.t.	
Lejohen	2830	Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore	
Lejohen	2841	Prodhimi i instrumenteve për punimin e metaleve	
Lejohen	2849	Prodhimi i instrumenteve të tjerë p.k.t.	
Lejohen	2891	Prodhimi i makinerive për metalurgjinë	
Lejohen	2892	Prodhimi i makinerive për industrinë nxjerrëse dhe ndërtim	
Lejohen	2893	Prodhimi i makinerive për përpunimin e ushqimeve, pijeve dhe duhanit	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	2894	Prodhimi i makinerive për prodhimin e tekstileve, veshjeve dhe lëkurave	
Lejohen	2895	Prodhimi i makinerive për prodhimin e letrës dhe të kartonit	
Lejohen	2896	Prodhimi i makinerive të plastikës dhe të kauçukut	
Lejohen	2899	Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm p.k.t.	
Lejohen	2910	Prodhimi i mjeteve të transportit	
Lejohen	2920	Prodhimi i karrocerive për mjetet e transportit: prodhimi i rimorkiove dhe gjysmërimorkiove	
Lejohen	3011	Ndërtimi i anijeve dhe i strukturave lundruese	
Lejohen	3012	Ndërtimi i barkave të argëtimit dhe sportive	
Lejohen	3020	Prodhimi i lokomotivave dhe mjetet mbështetëse të transportit hekurudhor	
Lejohen	3030	Prodhimi i avionëve dhe pjesëve që lidhen me to	
Lejohen	3040	Prodhimi i mjeteve luftarake të ushtrisë	
Lejohen	3091	Prodhimi i motoçikletave	
Lejohen	3092	Prodhimi i biçikletave dhe karrocave të invalidëve	
Lejohen	3099	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit p.k.t.	
Lejohen	3211	Prerja e monedhave	
Lejohen	3212	Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikuj të lidhur me to	
Lejohen	3213	Prodhimi i stolive imitacion dhe artikuj të ngjashëm me to	
Lejohen	3220	Prodhimi i instrumenteve muzikore	
Lejohen	3230	Prodhimi i artikujve të sportit	
Lejohen	3240	Prodhimi i lojërave dhe i lodrave	
Lejohen	3250	Prodhimi i instrumenteve dhe i pajisjeve mjekësore dhe dentare	Kujdes i shtuar për kontaktet fizike
Lejohen	3291	Prodhimi i fshesave dhe i furçave	
Lejohen	3299	Industri të tjera p.k.t.	
Lejohen	3311	Riparimi i produkteve metalike të fabrikuara	
Lejohen	3312	Riparimi i makinerive	
Lejohen	3313	Riparimi i pajisjeve elektronike dhe optike	
Lejohen	3314	Riparimi i pajisjeve elektrike	
Lejohen	3315	Riparimi dhe mirëmbajtja e anijeve dhe e barkave	
Lejohen	3316	Riparimi dhe mirëmbajtja e avionëve dhe mjeteve të hapësirës	
Lejohen	3317	Riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të tjera të transportit të p.k.t.	
Lejohen	3319	Riparimi i pajisjeve të tjera p.k.t.	
Lejohen	3320	Instalimi i makinerive dhe i pajisjeve industriale	
Lejohen	3511	Prodhimi i energjisë elektrike	
Lejohen	3512	Transmetimi i energjisë elektrike	
Lejohen	3513	Shpërndarja e energjisë elektrike	
Lejohen	3514	Tregtia e energjisë elektrike	
Lejohen	3521	Prodhimi i gazit	
Lejohen	3522	Shpërndarja e lëndëve djegëse të gazta nëpërmjet tubacioneve	
Lejohen	3523	Tregtia e gazit nëpërmjet tubacioneve	
Lejohen	3530	Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar	
Lejohen	3600	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	
Lejohen	3700	Ujërat e zeza	
Lejohen	3811	Grumbullimi i mbetjeve jo të rrezikshme	
Lejohen	3812	Grumbullimi i mbetjeve të rrezikshme	
Lejohen	3821	Trajtimi dhe heqja e mbetjeve jo të rrezikshme	
Lejohen	3822	Trajtimi dhe heqja e mbetjeve të rrezikshme	
Lejohen	3831	Çmontimi i pjesëve të shkatërruara	
Lejohen	3832	Rikuperimi i materialeve	
Lejohen	3900	Shërbime të tjera të pastrimit e të menaxhimit të mbetjeve	Kujdes i shtuar për kontaktet fizike
Lejohen	4110	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale dhe jorezidenciale	
Lejohen	4120	Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jorezidenciale	
Lejohen	4211	Ndërtimi i rrugëve dhe i autostradave	
Lejohen	4212	Ndërtimi i hekurudhave mbi dhe nëntokësore	
Lejohen	4213	Ndërtimi i urave dhe i tuneleve	
Lejohen	4221	Ndërtimi i veprave të tubacioneve e kanalizimeve	
Lejohen	4222	Ndërtimi i veprave të shërbimit komunal për energjinë elektrike dhe telekomunikacione	
Lejohen	4291	Ndërtimi i veprave ujore	
Lejohen	4299	Ndërtimi i veprave të tjera të inxhinierisë civile p.t.k.	
Lejohen	4311	Punime për prishje	
Lejohen	4312	Përgatitja e kantierit të ndërtimit	
Lejohen	4313	Shpime	
Lejohen	4321	Instalime elektrike	
Lejohen	4322	Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
		ajrit	
Lejohen	4329	Instalime të tjera elektrike	
Lejohen	4331	Punime suvatimi	
Lejohen	4332	Punime montimi	
Lejohen	4333	Punime për veshjen e dyshemeve dhe të mureve	
Lejohen	4334	Lyerja dhe vendosja e xhamave	
Lejohen	4339	Punime të tjera përfundimtare dhe finicioni të ndërtesave	
Lejohen	4391	Punime të çatisë	
Lejohen	4399	Të tjera punime të specializuara ndërtimi	
Lejohen	4511	Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël	
Lejohen	4519	Tregtia e automjeteve të tjera	
Lejohen	4520	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve (përfshirë gomisteritë)	
Lejohen	4531	Tregtia me shumicë e pjesëve dhe e aksesorëve të automjeteve	
Lejohen	4532	Tregtia me pakicë e pjesëve dhe e aksesorëve të automjeteve	
Lejohen	4540	Shitja, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe pjesëve dhe aksesorëve të tyre	
Lejohen	4611	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e lëndëve të para bujqësore, si kafshëve të gjalla; lëndë e parë tekstile, si dhe mallra gjysmë të gatshme	
Lejohen	4612	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale	
Lejohen	4613	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e lëndës drusore dhe të materialeve të ndërtimit	
Lejohen	4614	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e makinerive, pajisjeve industriale, anijeve dhe avionëve	
Lejohen	4615	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e mobilieve, mallrave shtëpiakë, artikuj elektronikë dhe hekurishte	
Lejohen	4616	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve, peliçeve, këpucëve dhe artikujve prej lëkure	
Lejohen	4617	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e mallrave ushqimore, pijeve dhe duhanit	
Lejohen	4618	Aktivitete të ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçanta ose grupe produktesh p.k.t.	
Lejohen	4619	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e një varieteti mallrash	
Lejohen	4621	Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve	Në tregje apo hapësira me mbi 25 persona, në një moment aplikohet protokolli portokalli për tregjet e hapura apo i përgjithshmi për hapësira të mbyllura
Lejohen	4622	Tregtia me shumicë e luleve dhe e bimëve	
Lejohen	4623	Tregtia me shumicë e kafshëve	
Lejohen	4624	Tregtia me shumicë e gëzofit, e lëkurës	
Lejohen	4631	Tregtia me shumicë e frutave dhe e perimeve	
Lejohen	4632	Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit	
Lejohen	4633	Tregtia me shumicë e produkteve bulmetore, vezëve dhe vajit të gatimit dhe yndyrave	Në tregje apo hapësira me mbi 25 persona, në një moment aplikohet protokolli portokalli për tregjet e hapura apo i përgjithshmi për hapësira të mbyllura
Lejohen	4634	Tregtia me shumicë e pijeve	
Lejohen	4635	Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit	
Lejohen	4636	Tregtia me shumicë e sheqerit dhe çokollatës dhe ëmbëlsirave	
Lejohen	4637	Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave	
Lejohen	4638	Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë të specializuar ushqimorë, përfshirë peshkun, krustacet dhe moluskët	Në tregje apo hapësira me mbi 25 persona, në një moment aplikohet protokolli portokalli për tregjet e hapura apo i përgjithshmi për hapësira të mbyllura
Lejohen	4639	Tregtia me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë, pije dhe duhan	
Lejohen	4641	Tregtia me shumicë e tekstileve	
Lejohen	4642	Tregtia me shumicë e veshjeve dhe e këpucëve	
Lejohen	4643	Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiake dhe radiove e televizorëve	
Lejohen	4644	Tregtia me shumicë e porcelaneve, qelqurinave dhe lëndëve të pastrimit të tyre	
Lejohen	4645	Tregtia me shumicë e artikujve të parfumerisë dhe të kozmetikës	
Lejohen	4646	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë	
Lejohen	4647	Tregtia me shumicë e mobilieve, qilimave dhe pajisjeve të ndriçimit	
Lejohen	4648	Tregtia me shumicë e orëve dhe e bizhuterive	
Lejohen	4649	Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë shtëpiakë	
Lejohen	4651	Tregtia me shumicë e kompjuterëve, pajisjeve periferike të kompjuterëve dhe programeve	Në tregje apo hapësira me mbi 25 persona, në një moment aplikohet protokolli portokalli për tregjet e hapura apo i përgjithshmi për hapësira të mbyllura
Lejohen	4652	Tregtia me shumicë e pajisjeve elektronike dhe të telekomunikacionit dhe pjesëve të tyre	
Lejohen	4661	Tregtia me shumicë e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe pjesëve	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	4662	Tregtia me shumicë e veglave të makinerive	
Lejohen	4663	Tregtia me shumicë makinerive të minierave, ndërtimit dhe për punime inxhinierike	
Lejohen	4664	Tregtia me shumicë makinerive të industrisë tekstile dhe të makinerive qepëse e thurëse	
Lejohen	4665	Tregtia me shumicë të mobilieve të zyrës	
Lejohen	4666	Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve të tjera të zyrës	
Lejohen	4669	Tregtia me shumicë e makinerive, pajisjeve dhe pjesëve p.k.t.	
Lejohen	4671	Tregtia me shumicë të lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to	
Lejohen	4672	Tregtia me shumicë e metaleve dhe e mineraleve	
Lejohen	4673	Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe e pajisjeve hidrosanitare	
Lejohen	4674	Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes dhe pjesëve të tyre	
Lejohen	4675	Tregtia me shumicë e produkteve kimike	
Lejohen	4676	Tregtia me shumicë e produkteve të tjera ndërmjetëse	
Lejohen	4677	Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe e skrapit	
Lejohen	4690	Tregtia me shumicë jo e specializuar	
Lejohen	4711	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan	
Mbyllen	**4719**	**Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara**	
Lejohen	4721	Tregtia me pakicë e frutave dhe e perimeve në dyqane të specializuara	
Lejohen	4722	Tregtia me pakicë e mishit dhe e prodhimeve të mishit në dyqane të specializuara	
Lejohen	4723	Tregtia me pakicë të peshkut, krustaceve dhe e molusqeve në dyqane të specializuara	
Lejohen	4724	Shitja me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve sheqeri në dyqane të specializuara (vetëm për *shërbim take away* dhe *delivery*)	
Lejohen	4725	Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara	
Lejohen	4726	Tregtia me pakicë e produkteve të duhanit në dyqane të specializuar	
Lejohen	4729	Tregtia me pakicë të produkteve të tjera ushqimore në dyqane të specializuara	
Lejohen	4730	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar	
Lejohen	4741	Tregtia me pakicë e kompjuterave, njësive periferike dhe *softweare* në dyqane të specializuara	
Mbyllen	**4742**	**Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuara**	
Mbyllen	**4743**	**Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara**	
Mbyllen	**4751**	**Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara**	
Lejohen	4752	Tregtia me pakicë e pjesëve elektronike, bojërave dhe xhamit në dyqane të specializuara	
Mbyllen	**4753**	**Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve në dyqane të specializuara**	
Lejohen	4754	Tregtia me pakicë e pajisjeve elekroshtëpiake në dyqane të specializuara (përveç makinave qepëse për përdorim shtëpiak)	
Mbyllen	**4759**	**Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara p.k.t.**	
Lejohen	4761	Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara	
Lejohen	4762	Tregtia me pakicë e gazetave dhe artikujve shkrimorë në dyqane të specializuara	
Mbyllen	**4763**	**Tregtia me pakicë e regjistruesve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara**	
Mbyllen	**4764**	**Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara**	
Mbyllen	**4765**	**Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave në dyqane të specializuara**	
Mbyllen	**4771**	**Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara**	
Mbyllen	**4772**	**Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara**	
Lejohen	4773	Shitja e përgatitja e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara	
Lejohen	4774	Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjekësorë në dyqane të specializuara	
Lejohen	4775	Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit në	Pa prekje fizike. Ajrosje e shtuar për parfumeritë

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
		dyqane të specializuara	
Mbyllen	**4776**	**Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehërues ve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara**	
Mbyllen	**4777**	**Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara**	
Mbyllen	**4778**	**Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara (përfshirë dhe "Tregtia me pakicë e armëve dhe municioneve, artikujve ushtarak"**	
Mbyllen	**4779**	**Tregtia me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane**	
Lejohen	4781	Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit	
Lejohen	4791	Tregtia me pakicë me porosi me *email* ose nëpërmjet internetit (përjashtohen shitjet përmes një demonstruesi ose një personi të shitjeve)	
Mbyllen	**4799**	**Tregtia me pakicë të artikujve të tjerë jo në dyqane, tenda ose tregje**	
Lejohen	4920	Transporti hekurudhor i mallrave	
Mbyllen	4932	**Aktiviteti i taksive**	Protokoll i veçantë taksi
Mbyllen	4939	**Transporte të tjera rrugor të pasagjerëve**	
Lejohen	4941	Transporti rrugor i mallrave	
Lejohen	4942	Shërbime të lëvizshme	
Lejohen	4950	Transporti me tubacion	
Lejohen	5020	Transporti ujor detar dhe bregdetar i mallrave	
Lejohen	5040	Transporti ujor i mallrave në ujëra të brendshme	
Lejohen	5121	Transporti ajror i mallrave	
Lejohen	5210	Magazinimi dhe ruajtja	
Lejohen	5221	Shërbime të ndryshme ndaj transportit tokësor	
Lejohen	5222	Shërbime të ndryshme ndaj transportit ujor	
Lejohen	5223	Shërbime të lidhura me transportin ajror	
Lejohen	5224	Dorëzimi i ngarkesës	
Lejohen	5229	Aktivitete të tjera mbështetëse të transportit	
Lejohen	5310	Aktivitete të postave me detyrimin e shërbimit të përgjithshëm	
Lejohen	5320	Aktivitete të tjera postare dhe të korrierës	
Lejohen	5530	Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	
Lejohen	5610	Shërbim ushqimor i lëvizshëm	
Lejohen	5621	Katering me porosi i cili duhet të shërbehet vetëm *take away* ose *delivery*	
Lejohen	5629	Aktivitetet e shërbimeve ushqimore të tjera (përjashtohen baret dhe restorantet dhe lejohen të gjitha subjektet të cilat tregtojnë ushqim të shpejtë (*fast food* ose byrektore) i cili duhet të shërbehet vetëm *take away* ose *delivery*)	
Mbyllen	**5630**	**Aktivitete të shërbimit të pijeve (bar, kafe dhe lokal)**	Vetëm *delivery* ose *take away*
Lejohen	5811	Publikimi i librave	
Lejohen	5812	Publikimi i listave të adresave postare	
Lejohen	5813	Publikimi i gazetave	
Lejohen	5814	Publikimi i revistave dhe i periodikëve	
Lejohen	5819	Aktivitete të tjera publikimi	
Lejohen	5821	Publikimi i lojërave kompjuterike	
Lejohen	5829	Publikimi i programeve të tjera	
Lejohen	5911	Filma, video dhe aktivitete të prodhimit të programeve televizive	Në set xhirimi jo më shumë se 10 persona në distancë
Lejohen	5912	Postproduksioni i filmave kinematografikë, të videove dhe të programeve televizive	
Lejohen	5913	Aktivitetet të shpërndarjes së filmave, videove dhe programeve televizive	
Lejohen	5914	Aktivitete të projeksionit të filmave	
Mbyllen	**5920**	**Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës**	Vetëm 2 persona në studio
Lejohen	6010	Transmetimi i programeve radiofonike	
Lejohen	6020	Aktivitete të programacionit dhe të transmetimit televiziv	
Lejohen	6110	Aktivitete të telekomunikacioneve (*wired*)	
Lejohen	6120	Aktivitete telekomunikacionit pa tel. (*wireless*)	
Lejohen	6130	Telekomunikacioni me satelit	
Lejohen	6190	Aktivitete të tjera të telekomunikacionit	
Lejohen	6201	Aktivitete të programimit informatik	
Lejohen	6202	Aktivitete të këshillimeve informatike	
Lejohen	6203	Aktivitete të menaxhimit të instalimeve informatike	
Lejohen	6209	Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	6311	Përpunimi i të dhënave, aktivitete mbajtëse (*hosting*) të informacioni dhe aktivitete të lidhura me to	
Lejohen	6312	Portat *web*	
Lejohen	6391	Aktivitete të agjencive të lajmeve	
Lejohen	6399	Shërbime të tjera informacioni p.k.t.	
Lejohen	6419	Ndërmjetësime të tjera financiare	
Lejohen	6420	Aktivitete të kompanive *hollding*	
Lejohen	6430	Truste, fonde dhe njësi të ngjashme financiare	
Lejohen	6491	*Leasing* (qiramarrja financiare)	
Lejohen	6492	Aktivitete të tjera garantimit të kredisë	
Lejohen	6499	Ndërmjetësime të tjera financiare, përveç sigurimit dhe fondeve të pensionit p.k.t.	
Lejohen	6511	Sigurimi i jetës	
Lejohen	6512	Sigurime jojetësore	
Lejohen	6520	Risigurimi	
Lejohen	6530	Financimi i pensioneve	
Lejohen	6611	Administrimi i tregjeve financiare	
Lejohen	6612	Aktivitete të sigurimit dhe kontratave të të mirave	
Lejohen	6619	Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar, përveç sigurimit dhe financimit pensioneve p.k.t.	
Lejohen	6621	Vlerësimi i riskut dhe i dëmit	
Lejohen	6622	Aktivitete të agjentëve të sigurimit dhe komisionerëve	
Lejohen	6629	Të tjera aktivitete ndihmëse të sigurimeve dhe financimit të pensioneve	
Lejohen	6630	Menaxhimi i fondeve	
Lejohen	6810	Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet	
Lejohen	6820	Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira (përjashtuar qendrat tregtare)	
Lejohen	6831	Agjencitë e pasurive të paluajtshme	
Lejohen	6832	Menaxhimi i pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë	
Lejohen	6910	Aktivitete juridike	
Lejohen	6920	Aktivitete të llogarive, mbajtjes së llogarive dhe aktivitete auditimi; konsulencë për taksat	
Lejohen	7010	Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve	
Lejohen	7021	Aktivitete të marrëdhënieve publike dhe të komunikimit	Kujdesi i shtuar
Lejohen	7022	Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin	
Lejohen	7111	Aktivitete arkitekturore	
Lejohen	7112	Aktivitete inxhinierike dhe konsulenca teknike të lidhura me to	
Lejohen	7120	Testimet dhe analizat teknike	
Lejohen	7219	Kërkime të tjera dhe zhvillime eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri	
Lejohen	7220	Kërkime dhe zhvillime eksperimentale në shkencat shoqërore dhe humane	
Lejohen	7311	Agjenci publiciteti	
Lejohen	7312	Shërbime të përfaqësimit të mediave	
Lejohen	7320	Studimi i tregut dhe sondazhet	
Lejohen	7410	Aktivitete të specializuara skicimi	
Lejohen	7420	Aktivitete fotografike	
Lejohen	7430	Aktivitete përkthimi dhe interpretimi	
Lejohen	7490	Të tjera aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t.	
Lejohen	7500	Aktivitete veterinare	
Lejohen	7711	Dhënia me qira dhe hua e mjeteve të transportit	
Lejohen	7712	Dhënia me qira dhe hua e kamionëve	
Lejohen	7721	Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve të kohës së lirë dhe e mallrave sportive	
Lejohen	7722	Dhënia me qira e video-tapes dhe disqeve	
Lejohen	7729	Dhënia me qira dhe hua e sendeve personale dhe e orendive shtëpiake të papërfshira	
Lejohen	7731	Dhënia me qira dhe hua e makinerive bujqësore dhe e pajisjeve	
Lejohen	7732	Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe e pajisjeve të ndërtimit e të punimeve inxhinierike	
Lejohen	7733	Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe e pajisjeve të zyrës (përfshirë kompjuterat)	
Lejohen	7734	Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve të transportit të ujit	
Lejohen	7735	Dhënia me qira dhe hua të pajisjeve të transportit ajror	
Lejohen	7739	Dhënien me qira dhe hua të makinerive dhe pajisjeve të tjera dhe mallrave të prekshme të papërfshira	
Lejohen	7740	Dhënia me qira e të mirave jofinanciare të patrupëzuara	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN JESHIL TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 1

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	7810	Aktivitete të agjencive të punësimit	
Lejohen	7820	Agjenci të punësimit të përkohshëm	
Lejohen	7830	Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore	
Lejohen	7911	Aktivitete të agjencive të udhëtimit	
Lejohen	7990	Të tjera aktivitete shërbimi për rezervim	
Lejohen	8010	Aktivitete private sigurimi	
Lejohen	8020	Aktivitete të shërbimeve të sigurimit	
Lejohen	8030	Aktivitete hetimi	
Lejohen	8110	Aktivitete të kombinuara për mbështetjen e strukturave	
Lejohen	8121	Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave	Kujdes i shtuar për kontakt fizik
Lejohen	8122	Aktivitete të tjera pastrimi të ndërtesave dhe pastrimi i objekteve industriale	Kujdes i shtuar për kontakt fizik
Lejohen	8129	Aktivitete të tjera pastrimi të papërfshira	Kujdes i shtuar për kontakt fizik
Lejohen	8211	Aktivitete të kombinuara të shërbimit të administrimit të zyrave	
Lejohen	8219	Fotokopjim, përgatitje dokumentesh dhe të tjera aktivitete mbështetëse të specializuara të zyrave	
Lejohen	8292	Aktivitete paketimi	
Lejohen	8299	Aktivitete të tjera shërbimi mbështetëse për bizneset p.k.t.	Njësitë e shërbimit në sportel zbatojnë protokollin portokalli
Lejohen	8411	Aktivitete të administratës së përgjithshme publike	
Lejohen	8412	Aktivitete të organizmave drejtues për shëndetin, arsimimin, kulturën dhe të tjera shërbime sociale, përveç sigurimit social	Njësitë e shërbimit në sportel zbatojnë protokollin portokalli
Lejohen	8413	Aktivitete të organizmave drejtues për aktivitetin ekonomik	
Lejohen	8421	Punët e jashtme	
Lejohen	8422	Aktivitete të mbrojtjes	
Lejohen	8423	Drejtësi dhe aktivitete juridike	
Lejohen	8425	Aktivitete shërbimi kundër zjarrit	
Lejohen	8430	Aktivitete të sigurimi të detyrueshëm	
Mbyllen	**9003**	**Krijimtari artistike**	Pa publik
Mbyllen	**9004**	**Shfrytëzimi i strukturave dhe i pajisjeve artistike**	Pa publik
Lejohen	9411	Aktivitetet e shoqatave e organizimeve ekonomike dhe punëdhënësve	
Lejohen	9412	Aktivitet e shoqatave profesionale	
Lejohen	9420	Aktivitetet e sindikatave të të punësuarve	
Lejohen	9491	Aktivitetet e organizatave fetare	
Lejohen	9492	Aktivitete të organizatave politike	
Lejohen	9499	Aktivitete të organizatave të tjera p.k.t.	Shmangie e grumbullimeve mbi 10 persona
Lejohen	9511	Riparimi i kompjuterëve dhe i pajisjeve periferike	
Lejohen	9512	Riparimi i pajisjeve të komunikimit	
Lejohen	9521	Riparimi i pajisjeve elektronike të konsumit	
Lejohen	9522	Riparimi i pajisjeve elektroshtëpiake dhe i pajisjeve për shtëpi dhe të kopshtarisë	
Lejohen	9523	Riparimi i këpucëve dhe i artikujve prej lëkure	
Lejohen	9524	Riparimi i mobilieve dhe i orendive shtëpiake	
Lejohen	9525	Riparimi i orëve, orëve të murit dhe bizhuterive	
Lejohen	9529	Riparimi i artikujve personalë dhe familjar p.k.t.	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN PORTOKALLI TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 2

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	510	Nxjerrja e qymyrit	
Lejohen	520	Nxjerrja e linjiteve	
Lejohen	710	Nxjerrja e mineraleve hekurore	
Lejohen	721	Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe të toriumit	
Lejohen	729	Nxjerrja e mineraleve të tjera jometalore	
Lejohen	1104	Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padistiluara	0–25 punëtorë: protokoll jeshil; 25–50 punëtorë: protokoll portokalli; mbi 50 punëtorë protokolli i kuq
Lejohen	1106	Prodhimi i maltës	
Lejohen	1200	Prodhimi i produkteve të duhanit	
Lejohen	1393	Prodhimi i tapeteve dhe i qilimave	
Lejohen	2042	Përpunimi i parfumeve dhe i solucioneve të tualetit	
Lejohen	2351	Prodhimi i çimentos	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN PORTOKALLI TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 2

Lejohen	2352	Prodhimi i allçisë dhe i gëlqeres	
Lejohen	2361	Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi	
Lejohen	2399	Prodhimi i produkteve minerale j metalike p.k.t.	
Lejohen	2410	Siderurgjia, prodhimi i hekurit dhe çelikut dhe ferroalizheve	
Lejohen	2420	Prodhimi i tubave, tubacioneve dhe profilet e lugëta dhe pjesë të tjera prej çeliku	
Lejohen	2442	Prodhimi i aluminit	
Lejohen	2443	Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit	
Lejohen	2444	Prodhimi i bakrit	
Lejohen	2445	Prodhimi i metaleve të tjera joferrike	
Lejohen	2451	Derdhja (fonderia) e gizës	
Lejohen	2452	Derdhja (fonderia) e çelikut	
Lejohen	2453	Derdhja (fonderia) e metaleve të lehta	
Lejohen	2454	Derdhja (fonderia) e metaleve të tjera joferrike	
Lejohen	2511	Prodhimi i strukturave metalike dhe pjesët e strukturave	
Lejohen	2931	Prodhimi i pjesëve elektrike dhe elektronike për mjetet e transportit dhe motorët e tyre	
Lejohen	2932	Prodhimi i pjesëve dhe i aksesorëve të tjerë për mjetet e transportit dhe motorët e tyre	
Lejohen	3101	Prodhimi i mobilieve të zyrave dhe dyqaneve	
Lejohen	3102	Prodhimi i mobilieve të kuzhinës	
Lejohen	3103	Prodhimi i dyshekëve	
Lejohen	3109	Prodhimi i mobilieve të tjera	
Mbyllen	**4782**	**Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të tekstileve, veshjeve dhe këpucëve**	
Mbyllen	**4789**	**Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të mallrave të tjera**	Protokoll i veçantë portokalli tregjet e hapura
Mbyllen	4910	**Transporti hekurudhor interurban i pasagjerëve**	Protokoll i veçantë portokalli transport interurban
Mbyllen	4931	**Transporti rrugor i pasagjerëve me sistemin urban**	Protokoll i veçantë portokalli transport urban
Lejohen	5030	Transporti ujor i pasagjerëve në ujëra të brendshme	
Lejohen	5510	Hotele dhe struktura të ngjashme	
Lejohen	5520	Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive	
Lejohen	5590	Akomodime të tjera	Në varësi të numrit të akomoduarve duhet vendosur tunel *spray*
Lejohen	6411	Aktiviteti i bankës qendrore	Bankat dhe institucionet financiare zbatojnë protokollin portokalli banke
Lejohen	7211	Kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në bioteknologji	
Lejohen	7912	Aktivitete të operatorëve turistikë	
Lejohen	8130	Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve	
Lejohen	8230	Organizatorë të konferencave dhe të panaireve	
Lejohen	8291	Aktivitete të agjencive të mbledhjes së dokumentacionit dhe zyra krediti	
Lejohen	8424	Aktivitete të rendit publik dhe të sigurimit	
Lejohen	8610	Aktivitete të spitaleve	
Lejohen	8621	Aktivitete të mjekëve të përgjithshëm	
Lejohen	8622	Aktivitete të mjekëve të specializuar	
Mbyllen	8623	Aktivitete të dentistëve	Pa tunel *spray*
Lejohen	8690	Të tjera aktivitete të shëndetit	
Lejohen	8710	Aktivitete të qendrave të kujdesit infermieror	
Lejohen	8720	Aktivitete të qendrave të kujdesit për prapambetjet mendore, shëndetit mendor dhe abuzimit me substanca narkotike	
Lejohen	8790	Aktivitete të qendrave të tjera kujdesit p.k.t.	
Lejohen	8891	Aktivitete të kujdesit ditor të fëmijëve	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN PORTOKALLI TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 2

Lejohen	8899	Aktivitete të tjera të kujdesit sociale pa akomodim p.k.t.	
Mbyllen	**9001**	**Shfaqje artistike**	Pa publik
Mbyllen	**9002**	**Aktivitete mbështetëse për shfaqje artistike**	Pa publik
Mbyllen	**9101**	**Aktivitete të bibliotekave dhe arkivave**	Pa qëndrim në ambient
Mbyllen	**9102**	**Aktivitete të muzeve**	Me rezervim orari *online*. Jo më shume se 50 persona në një moment
Mbyllen	**9103**	**Funksionimi i vendeve dhe ndërtesave historike të ngjashme tërheqëse për vizitorët**	Me rezervim orari *online*. Jo më shume se 50 persona në një moment
Mbyllen	**9104**	**Kopshte botanike dhe zoologjike dhe aktivitete të rezervateve natyrore**	Me rezervim orari *online*. Jo më shume se 50 persona në një moment
Mbyllen	**9200**	**Aktivitete të lojërave të fatit dhe basteve**	Nuk lejohen me ligj
Mbyllen	**9313**	**Palestra**	Me rezervim orari *online*. Për çdo 4 metra katrorë lejohet 1 abonent shtesë
Mbyllen	**9321**	**Aktivitete të parqeve të argëtimit dhe atyre me orientim të caktuar**	Me kufizime orari dhe duke shmangur grumbullimet e me shume se 50 personave në një moment
Mbyllen	**9329**	**Aktivitete të tjera argëtimi dhe çlodhëse p.k.t.**	Me kufizime orari dhe duke shmangur grumbullimet e me shume se 50 personave në një moment
Mbyllen	**9602**	**Flokët dhe trajtime të tjera të bukurisë**	**Pa tunel *spray***
Mbyllen	**9604**	**Aktivitete të mirëmbajtjes trupore**	**Pa tunel *spray***
Mbyllen	6831	Qendrat tregtare	Protokoll i veçantë qendra tregtare

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN E KUQ TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 3

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
Lejohen	1011	Prodhimi dhe përpunimi i mishit	0–25 punëtorë: protokoll jeshil; 25–50 punëtorë: protokoll portokalli; mbi 50 punëtorë protokolli i kuq
Lejohen	1012	Prodhimi dhe përpunimi i mishit të shpendëve	
Lejohen	1013	Prodhimi i produkteve të mishit dhe mishit të shpendëve	
Lejohen	1020	Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve	
Lejohen	1031	Përpunimi dhe konservimi i patates	
Lejohen	1032	Përpunimi i lëngut të frutave dhe i perimeve	
Lejohen	1039	Procese të tjera përpunimi dhe konservimi të frutave dhe perimeve	0–25 punëtorë: protokoll jeshil; 25–50 punëtorë: protokoll portokalli; mbi 50 punëtorë protokolli i kuq
Lejohen	1041	Përpunimi i vajrave dhe i yndyrave	
Lejohen	1042	Prodhimi i margarinës dhe yndyrave të tjera të ngjashme	
Lejohen	1051	Përpunimi i produkteve të qumështit	
Lejohen	1052	Prodhimi i akullores	
Lejohen	1061	Përpunimi i produkteve të drithërave	
Lejohen	1062	Prodhimi i niseshtesë dhe i produkteve të niseshtesë	
Lejohen	1071	Prodhimi i bukës; prodhimi pastave të freskëta dhe i kekëve	
Lejohen	1072	Prodhimi i biskotave dhe i galetave; prodhimi i pastave dhe i kekëve të konservuar	0–25 punëtorë: protokoll jeshil; 25–50 punëtorë: protokoll portokalli; mbi 50 punëtorë protokolli i kuq
Lejohen	1073	Prodhimi i makaronave	
Lejohen	1081	Prodhimi i sheqerit	
Lejohen	1082	Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe ëmbëlsirave	
Lejohen	1083	Përpunimi i çajit dhe kafes	
Lejohen	1084	Prodhimi i erëzave dhe i salcave	
Lejohen	1085	Prodhimin e ushqimeve të përgatitura	
Lejohen	1086	Përgatitja e ushqimeve të homogjenizuara dhe të ushqimeve dietetike	0–25 punëtorë: protokoll jeshil; 25–50 punëtorë: protokoll portokalli; mbi 50 punëtorë protokolli i kuq
Lejohen	1089	Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t	
Lejohen	1091	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për	

KATEGORITË E BIZNESEVE QË DUHET TË ZBATOJNË PROTOKOLLIN E KUQ TË MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE TË DISTANCIMIT SOCIAL

Tabela 3

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
		kafshët e fermës	
Lejohen	1092	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake	
Lejohen	1101	Distilimi, rektifikimi dhe kombinimi i pijeve	
Lejohen	1105	Prodhimi i birrës	
Lejohen	1107	Prodhimin e pijeve të tavolinës; prodhimi i ujit mineral dhe ujërave të tjerë në shishe	0–25 punëtorë: protokoll jeshil; 25–50 punëtorë: protokoll portokalli; mbi 50 punëtorë protokolli i kuq
Lejohen	1310	Përgatitja e fibrave tekstile dhe filatura	Protokolli i kuq fason
Lejohen	1320	Endja e tekstileve	
Lejohen	1330	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstileve	
Lejohen	1391	Prodhimi i tekstileve të tjera, pëlhurave të endura dhe thurura	
Lejohen	1392	Prodhimi i artikujve tekstile të konfeksionuar, përveç veshjeve	
Lejohen	1395	Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve	Protokolli i kuq fason
Lejohen	1396	Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industrialë	
Lejohen	1399	Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t.	
Lejohen	1411	Konfeksionimi i veshjeve prej lëkure	
Lejohen	1412	Konfeksionimi i veshjeve të punës	
Lejohen	1413	Konfeksionimi i veshjeve të tjera të jashtme	
Lejohen	1414	Konfeksionimi i veshjeve të brendshme	
Lejohen	1419	Konfeksionimi i veshjeve të tjera dhe aksesorë	
Lejohen	1420	Konfeksionimi i artikujve prej gëzofi	
Lejohen	1431	Konfeksionimi i trikotazheve me thyesa	
Lejohen	1439	Konfeksionimin e veshjeve të tjera me thyesa	
Lejohen	1511	Tanini dhe regjja e lëkurës dhe ngjyrosja e gëzofit	
Lejohen	1512	Prodhimi i valixheve, çantave të dorës dhe të ngjashme, pajimeve të kuajve dhe të tjerë	Protokolli i kuq fason
Lejohen	1520	Prodhimi i këpucëve	
Mbyllen	5010	**Transporti detar dhe bregdetar i pasagjerëve**	Protokoll i veçantë i kuq port detar
Mbyllen	5110	**Transporti ajror i pasagjerëve**	Protokoll i veçantë i kuq aeroport
Lejohen	8220	Aktivitete të qendrave telefonike (*call center*)	Zbatojnë protokollin e kuq *call center*
Mbyllen	**8510**	**Arsimi parashkollor**	
Mbyllen	**8520**	**Arsimi fillor (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8531**	**Arsimi sekondar i përgjithshëm (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8532**	**Arsim i mesëm teknik dhe profesional (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8541**	**Arsimi pas të mesmes jo i lartë (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8542**	**Arsimi i lartë (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8551**	**Arsimi për sporte dhe argëtim (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8552**	**Arsim kulturor (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8553**	**Aktivitete të shkollave të drejtimit të mjeteve (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8559**	**Të tjera shkollime (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Mbyllen	**8560**	**Shërbime arsimore mbështetëse (përjashtuar mësimdhënia *online*)**	
Lejohen	8730	Aktivitete qendrave të kujdesi shëndetësor për të moshuarit dhe të personave me paaftësi	
Lejohen	8810	Aktivitete të kujdesit social pa akomodim për të	

Tabela 3

Statusi	Klasa	Klasa, përshkrimi	Komente
		moshuar dhe të paaftë	
Mbyllen	**9311**	**Funksionimi i strukturave sportive**	Pa publik
Mbyllen	**9312**	**Aktivitete të klubeve sportive**	Pa publik
Mbyllen	**9319**	**Aktivitete të tjera sportive**	Pa publik

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KOMITETI I PËRKOHSHËM PËR INFEKSIONIN E PËRHAPUR NGA CORONAVIRUS I RI

PROTOKOLLI JESHIL I MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE I DISTANCIMIT SOCIAL

1. Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut, sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier ku një subjekt ushtron disa aktivitetet, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti.
2. Person i caktuar nga administratori/personi fizik kryen çdo ditë vetëvlerësimin personal dhe të personave të punësuar nëse kanë simptoma të COVID-19, sipas *check*-listës së miratuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127.
3. Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar.
4. Personeli i punësuar/administratori/personi fizik tregtar duhet të mbajë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën.
5. Personeli i punësuar/administratori/personi fizik tregtar duhet të përdorë dorezat mbrojtëse sipas këshillave.
6. Në hyrje subjekti duhet të ofrojë produktin higjienizues të duarve për klientët dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60%.

7. Klienti dezinfekton duart në hyrje dhe në dalje nga subjekti. Klienti mban dorezat dhe maskën mbrojtëse sipas këshillave.

8. Duhet të garantohet dhe të respektohet në çdo moment distanca prej 2 m midis klientit dhe personelit të punësuar.

9. Punonjësi i arkës lan duart dhe i dezinfekton ato para veshjes dhe pas zhveshjes së dorezave.

10. Subjekti shërben vetëm një klienti në ambient, ndërkohë që të tjerët presin jashtë në radhë me distancë 2 metra nga njëri-tjetri. Në ambientet më hapësirë mbi 30 metra katrorë mund të lejohet proporcionalisht një klient tepër për çdo 10 metra katrorë shtesë ambienti duke orientuar klientët në ruajtjen e distancës.

11. Subjekti duhet të afishojë në një vend të dukshëm në fasadë mundësinë e blerjeve *online*, mundësinë e rezervimit të takimit *online* apo me telefon.

12. Subjekti duhet të vendosë xham mbrojtës (ose *plexiglass*) klient shitës dhe shirit distance në banakun e arkës.

13. Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik shitës-klient.

14. Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes, sidomos të tavolinave, banakëve, telefonave dhe çdo hapësire ku ka pasur kontakt prekjeje.

15. Subjekti duhet të sigurojë ajrim, sipas mundësisë minimalisht 3 herë në ditë. Ky detyrim për subjektet si parfumeri apo gjatë të cilave prodhohen gazra duhet të kryhet 6 herë në ditë.

16. Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19, sipas *check*-listës së miratuar.

17. Për çdo rast administratori/personi fizik tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht njësinë vendore të kujdesit shëndetësor dhe Inspektoratin Shëndetësor Shtetëror.

18. Subjekti duhet të afishojë detyrimin për vetëvlerësim të simptomave nga klientët dhe personeli i punësuar/administratori/personi fizik tregtar, sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat, sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KOMITETI I PËRKOHSHËM PËR INFEKSIONIN E PËRHAPUR NGA CORONAVIRUS I RI

PROTOKOLLI I VERDHË I MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE I DISTANCIMIT SOCIAL

1. Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij, duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut, sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier, ku një subjekt ushtron disa aktivitetet, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti. Këtij protokolli u nënshtrohen edhe aktivitetet që kanë 25–50 punonjës që punojnë në një ambient të përbashkët të mbyllur.

2. Personi i caktuar nga administratori/personi fizik kryen çdo ditë vlerësimin për prezencën e simptomave të COVID-19 në personat e punësuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në

numrin 127. Nëse personi shfaq simptoma, ndërkohë që është duke punuar apo pas punës, ky person duhet të karantinohet në një ambient të veçuar të objektit, derisa të merren masat përkatëse nga shërbimet shëndetësore.

3. Për çdo rast administratori/personi fizik tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht njësinë vendore të kujdesit shëndetësor dhe Inspektoratin Shëndetësor Shtetëror.

4. Personi i caktuar nga administratori/personi fizik mat temperaturën e punonjësve dhe të çdo personi tjetër klient në hyrje dhe në dalje me termometër *infrared* dhe njofton menjëherë strukturat përkatëse për temperaturat me të larta se 37,5 gradë në rastet kur ka edhe simptoma të tjera të COVID-19.

5. Pavarësisht sa më sipër, personat e punësuar kryejnë çdo ditë vetëvlerësimin personal nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas *check*-listës së miratuar. Në rast të simptomave personi duhet të njoftojë menjëherë 127-ën dhe administratorin/personin fizik tregtar. Për çdo rast administratori/personi fizik tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht njësinë vendore të kujdesit shëndetësor dhe Inspektoratin Shëndetësor Shtetëror. Nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe sipas rastit duhet të karantinohet në ambientin e paracaktuar.

6. Çdo punonjës është i detyruar të deklarojë ndaj administratorit/personit fizik tregtar nëse ka pasur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitiv me COVID-19.

7. Çdo punonjës që vëren shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqitet në punë dhe duhet të lajmërojë menjëherë administratorin/personin fizik tregtar. Punonjësi duhet të telefonojë 127-ën dhe mjekun e familjes.

8. Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar nga dispozitat ligjore.

9. Vajtja dhe ardhja në punë në këmbë kryhet duke ruajtur distancën 2 metra dhe jo duke krijuar grupime. Në rast të vajtje-ardhjes në punë me shërbim transporti me autobusë, punonjësit ulen në anësoret e dritareve të autobusit dhe duke lënë një hapësirë rreshti bosh pas tyre. Në autobus apo automjet duhet mbajtur detyrimisht maska dhe dorezat dhe të shmanget prekja e sipërfaqeve. Autobusi dezinfektohet dhe ajroset çdo ditë. Për lëvizjen me automjet të zbatohen masat e publikuara nga Policia e Shtetit.

10. Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment doreza mbrojtëse, maska dhe higjienizues duarsh me mbi 60% alkool.

11. Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment sapun, letër për pastrimin e duarve, dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve, si dhe kosha plehrash të mbyllur të cilët duhen pastruar çdo ditë.

12. Personeli i punësuar dhe personat e tjerë klientë duhet të përdorin dorezat mbrojtëse sipas këshillave.

13. Personeli i punësuar dhe personat e tjerë klientë duhet të mbajnë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën.

14. Kollitja dhe teshtitja kryhen duke përdorur bërrylin apo letër hundësh. Letra hidhet menjëherë në kosh.

15. Në hyrje dhe në dalje subjekti duhet të ofrojë produktin higjienizues të duarve për personelin dhe këdo që hyn e del në ambientet e brendshme dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60% alkool.

16. Subjekti duhet të garantojë dhe të respektojë në çdo moment distancën prej 2 metra midis personelit të punësuar dhe të këtyre të fundit e klientëve. Subjekti riorganizon punën e tij me turne, sipas një plani individual, në mënyrë që të respektojë detyrimin e mësipërm.

17. Subjekti shërben aq klientë sa sportele arke apo shërbim klienti ka, ndërkohë që të tjerët presin jashtë në radhë.

18. Rekomandohet shmangia e parasë *cash* dhe ofrimi shërbimeve me pagesë me kartë krediti.

19. Subjekti vendos xham mbrojtës (*plexiglass*) midis punonjësit dhe klientit.

20. Në çdo rast të sigurohet ventilim (ajrimi) natyral të paktën 5 herë në ditë. Subjektet të marrin masat përkatëse për ndërhyrje në sistemet e ventilimit ku të kalohet në modalitetin e ajrit natyral apo përmes shtimit të dritareve.

21. Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik mes punonjësve apo mes palëve të treta përfshirë përshëndetjet.

22. Gjatë pushimit apo orarit të ngrënies të shmanget grumbullimi i personave në ambiente, si kuzhina, dhoma ngrënieje apo ambiente të jashtme qoftë të subjektit apo publike.

23. Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes dhe të paktën 3 herë në ditë. Secili punonjës kryen dezinfektimin me produktet e higjienës së tavolinave, banakëve, telefonave, kompjuterave, kufjeve dhe çdo hapësire apo objekti ku ka pasur kontakt prekjeje në fillim dhe në përfundim të turnit. Produktet përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse nga prodhuesi/shitësi apo Ministria e Shëndetësisë.

24. Punonjësit gjatë punës nuk duhet të përdorin mjetet apo vendin e punës së kolegëve pa kryer dezinfektimin.

25. Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19, sipas *check*-listës së miratuar.

26. Subjekti duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19, sipas formatit të miratuar.

27. Subjekti duhet të afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit portokalli, sipas formatit të miratuar, ku përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/administratori/çdo person tjetër palë e tretë që hyn e del në ambientet e brendshme, sipas formatit të miratuar, ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.

28. Subjekti të afishojë të plotë protokollin portokalli sipas tekstit të miratuar.

29. Materialet e mësipërme afishohen në hyrje të subjektit, si dhe në vende të dukshme në brendësi të subjektit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

KOMITETI I PËRKOHSHËM PËR INFEKSIONIN E PËRHAPUR NGA CORONAVIRUS I RI

PROTOKOLLI I KUQ I MASAVE HIGJIENO-SANITARE DHE I DISTANCIMIT SOCIAL

1. Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij, duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier ku një subjekt ushtron disa aktivitetet, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti.

2. Këtij protokolli u nënshtrohen edhe aktivitetet që kanë mbi 50 punonjës që punojnë në një ambient të përbashkët të mbyllur.

3. Subjekti detyrimisht ka të punësuar me kohë të plotë mjekun e ndërmarrjes. Nuk lejohet që mjeku i ndërrmarrjes të ofrojë shërbimin e tij në më tepër se një sublekt.Administratori i subjektit ka detyrimin e njoftimit pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të gjeneraliteteve dhe të numrit të licencës së mjekut të

ndërmarrjes. Mjeku i ndërmarrjes dhe/ose administratori janë përgjegjës për implementimin e masave, sipas këtij protokolli, sipas detyrimeve të secilit prej tyre.

4. Mjeku i ndërmarrjes kryen çdo ditë vlerësimin për prezencën e simptomave të COVID-19 në personat e punësuar dhe të kujtdo që hyn e del në ambientet e punës, përfshirë administratorin, transportuesit, shpërndarësit, palë të treta që janë pjesë e zinxhirit furnizim, shpërndarje, shitje etj. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast në numrin 127. Nëse personi shfaq simptoma ndërkohë që është duke punuar apo pas punës, ky person duhet të karantinohet në një ambient të veçuar të ndërmarrjes, derisa të merren masat përkatëse nga shërbimet shëndetësore.

5. Për çdo rast mjeku i ndërrmarrjes dhe administratori lajmërojnë menjëherë strukturat përkatëse, veçanërisht njësinë vendore të kujdesit shëndetësor dhe Inspektoratin Shëndetësor Shtetëror.

6. Mjeku i ndërmarrjes mat temperaturën e punonjësve/administratorit apo çdo personi tjetër në hyrje dhe dalje me termometër *infrared* dhe mban librin përkatës me shënimet çdo ditë për temperaturat me të larta se 37,5 gradë apo të shfaqjes së simptomave të tjera. Mjeku administron të dhënat mjekësore, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale sensitive dhe ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit.

7. Pavarësisht sa më sipër, personat e punësuar kryejnë çdo ditë vetëvlerësimin personal nëse kanë simptoma të COVID-19, sipas *check*-listës së miratuar. Në rast të simptomave personi duhet të njoftojë menjëherë 127-ën dhe mjekun e ndërmarrjes për shëndetin në punë. Nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe, sipas rastit duhet të karantinohet në ambientin e paracaktuar.

8. Çdo punonjës është i detyruar të deklarojë ndaj administratorit dhe mjekut të ndërmarrjes, nëse ka pasur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitivë me COVID-19.

9. Çdo punonjës që vëren shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqitet në punë dhe duhet të lajmërojë menjëherë administratorin dhe mjekun e ndërmarrjes. Punonjësi duhet të telefonojë 127-ën dhe mjekun e familjes.

10. Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar nga dispozitat ligjore.

11. Vajtja dhe ardhja në punë në këmbë kryhet duke ruajtur distancën 2 metra dhe jo duke krijuar grupime. Në rast të vajtje-ardhjes në punë me shërbim transporti me autobusë, punonjësit ulen në anësoret e dritareve të autobusit dhe duke lënë një hapësirë rreshti bosh pas tyre. Në autobus apo automjet duhet mbajtur detyrimisht maska dhe dorezat dhe të shmanget prekja e sipërfaqeve. Autobusi dezinfektohet dhe ajroset çdo ditë. Për lëvizjen me automjet të zbatohen masat e publikuara nga Policia e Shtetit.

12. Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment doreza mbrojtëse, maska dhe higjienizues duarsh me mbi 60% alkool.

13. Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment sapun, letër për pastrimin e duarve, dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve, si dhe kosha plehrash të mbyllur të cilët duhen pastruar çdo ditë.

14. Personeli i punësuar/administratori/personat e tjerë duhet të përdorin dorezat mbrojtëse sipas këshillave.

15. Personeli i punësuar/administratori/ personat e tjerë duhet të mbajnë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën.

16. Kollitja dhe teshtitja kryhen duke përdorur bërrylin apo letër hundësh.

17. Në hyrje dhe në dalje subjekti duhet të ofrojë produktin higjienizues të duarve për personelin dhe këdo që hyn e del në ndërmarrje dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60% alkool.

18. Subjekti duhet të garantojë dhe të respektojë në çdo moment distancën prej 2 metra midis personelit të punësuar. Subjekti riorganizon punën e tij me turne, sipas një plani individual në mënyrë që të respektojë detyrimin e mësipërm.

19. Në çdo rast të sigurohet ventilim (ajrimi) natyral të paktën 5 herë në ditë. Subjektet të marrin masat përkatëse për ndërhyrje në sistemet e ventilimit ku të kalohet në modalitetin e ajrit natyral apo përmes shtimit të dritareve.

20. Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik mes punonjësve apo mes palëve të treta si transportues, shpërndarës etj., përfshirë përshëndetjet.

21. Gjatë pushimit apo orarit të ngrënies të shmanget grumbullimi i personave në ambiente, si kuzhina, dhoma ngrënieje apo ambiente të jashtme qoftë të subjektit apo publike.

22. Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes dhe të paktën 5 herë në ditë. Secili punonjës kryen dezinfektimin me produktet e higjienës të tavolinave, banakëve, telefonave dhe çdo hapësire ku ka pasur kontakt prekjeje në fillim dhe përfundim të turnit. Produktet përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse nga prodhuesi/shitësi apo Ministria e Shëndetësisë.

23. Punonjësit gjatë punës nuk duhet të përdorin mjetet apo vendin e punës së kolegëve.

24. Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19, sipas *check*-listës së miratuar.

25. Subjekti duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19, sipas formatit të miratuar.

26. Subjekti duhet të afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit të kuq, sipas formatit të miratuar ku përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/administratori/çdo person tjetër palë e tretë që hyn e del në ndërmarrje, sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat, sipas detyrimeve ligjore dhe numri jeshil për denoncim.

27. Subjekti të afishojë të plotë protokollin e kuq, sipas tekstit të miratuar.

28. Materialet e mësipërme afishohen në hyrje të subjektit, si dhe në vende të dukshme në brendësi të ndërmarrjes.